

LIGJ

PER PAFAJESINE, AMNISTINE DHE REHABILITIMIN E ISH TE DENUARVE DHE TE PERNDJEKURVE POLITIKE

Gjate 45 vjeteve, shume qytetare shqiptare jane akuzuar, gjykuar, denuar dhe burgosur, internuar apo perndjekur per shkelje te natyres politike, duke dhunuar te drejtat e tyre civile, sociale, morale dhe ekonomike.

Parlamenti i pare pluralist i Republikes se Shqiperise, ka vendosur te krijojte nje sistem juridik te drejte e te ndershem, qe te perputhet plotesisht me ligjet dhe rregullat qe mbrojne te drejtat baze njerezore. Eshte adaptuar dhe po konsolidohet nje program i pajtimit kombetar nepermjet te cilit u jepen gjithte qytetareve shqiptare garancite per te ushtruar te drejtat e tyre civile nepermjet rrugeve ligjore, si baze e rivendosjes se nje shoqerie te lire dhe demokratike. Per kete arsye, Kuvendi Popullor, duke perdorur kompetencat e tij, u jep ish te burgosurve dhe te perndjekurve politike pafajesine dhe e konsideron ne nderin e vet qe, si perfaqesuesi me i larte i popullit, ne emer te shtetit juridik t'u kerkoje falje ketyre njerezve per denimet politike dhe vuajtjet qe kane pesuar ne te kaluaren.

Qeveria do te marre te gjitha masat qe te kompensoje dhe rehabilitoje te gjithte personat qe jane akuzuar padrejtesisht per shkelje per te cilat ben fjale ky ligj dhe te siguroje per ta, me perparesi, ndihmen materiale dhe morale per t'u riintegruar plotesisht ne shoqeri.

Ne mbeshtetje te nenit 16-te, pika 6 te ligjit nr.7491, date 24.4.1991, "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Jane te pafajshem dhe quhen te padenuar per efekte morale, politike, sociale dhe ekonomike te gjithte personat qe jane denuar per agjitacion e propagande kunder shtetit, per arratisje, per sabotim, per krijimin ose pjesemarrjen ne organizata politike, per moskallezim te krimeve kunder shtetit; ata qe jane denuar per shpifje dhe fyerje kunder organeve me te larta te shtetit e te Partise, per shkelje te dekretit nr.7459, date 22.1.1991 "Per respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve qe lidhen me historine kombetare dhe te simboleve shteterore", si dhe per shkelje te dekretit nr. 7408, date 31.7.1990 "Per mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve ne vendet publike".

Neni 2

Jane te pafajshem te gjithë shtetasit shqiptare që janë arratisur nga Shqipëria gjatë luftes ose pas Çlirimit të vendit deri më 8 maj 1990, për shkak të bindjeve ose të veprimtarisë së tyre politike me përjashtim të atyre që kanë kryer akte terroriste e diversioni, kur këto vepra kanë sjelle vdekje ose pasoja të tjera të rënda. Të tjerët amnistohen.

Neni 3

Nga ky ligj përfitojnë edhe ushtarakët që duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror kanë kryer dhe veprën penale të largimit pa leje dhe shmangien përgjithmone nga shërbimi ushtarak.

Neni 4

Amnistohen të gjithë të denuarit për krime kundër shtetit dhe për moskallelzim e perkrahje të këtyre krimeve, me përjashtim të atyre që kanë kryer akte terrori e diversioni, kur këto vepra kanë sjelle vdekje ose pasoja të tjera të rënda.

Pushohen ndjekjet penale për veprat penale të parashikuara nga ky nen, si dhe nga nenet e mësipërme të këtij ligji për të gjitha çështjet hetimore, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat dhe për të gjithë kallelzimet e bera para organeve kompetente për këto vepra penale të kryera gjatë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Personave që përfitojnë nga neni 1 i këtij ligji, u njihen këto të drejta:

- a. U njihet e vlefshme për efekt vjetërsie në punë ose shërbimi koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirise dhe me internim si dënim penal plotësues. Vjetërsia në punë për kohën e vuajtjes së dënimit u njihet dhe personave që kanë qenë pa punë para fillimit të ndjekjes penale.
Për efekt të llogaritjes së pensionit, personat e denuar gëzojnë të drejtën e zgjedhjes së pages mesatare mujore të marre gjatë tre vjeteve me radhë brenda dhjetë vjeteve të fundit të punës, para ose pas procedimit penal, ose të pages së marre nga punëtori, që ka punuar me kushte të njejta pune me atë që ka kryer i denuari gjatë vuajtjes së dënimit. Kur kjo zgjedhje nuk mund të bëhet për shkak të ndryshme, atyre u jepet pensioni mesatar.
- b. U kthehen titujt e nderit dhe dekoratat që u janë hequr me vendim të gjykatës ose me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor.
- c. T'u sigurohet kthimi në qendren e banimit ku kanë qenë para ndjekjes penale ose internimit; t'u sigurohet punë sipas profesionit të tyre, me përparësi brenda ose jashtë shtetit dhe t'u kthehet precedenca për strehim.
- c. T'u kthehet e drejta e studimit në shkollat e larta atyre që u është hequr kjo e drejtë, për shkak të procedimit penal të tyre ose të personave të afërm dhe t'u sigurohet arsimimi sa më i shpejtë brenda ose jashtë shtetit.
- d. U bëhet kompensim për demot e shkaktuara dhe u jepet një shpërblim i caktuar për plotësimin e kushteve të jetesës, sipas rregullave që do të vendosen me dispozita të veçanta në përputhje me kriteret ndërkombëtare. U njihet e drejta e kthimit ose e kompensimit të pasurive të konfiskuara.

dh. Kompensim per demet e shkaktuara u jepet dhe familjeve ose trashegimtareve te ligjshem te ish te burgosurve politike qe nuk jetojne me si dhe te atyre qe jane pushkatuar pa gjyq ose qe kane vdekur pa u denuar nga gjykata.

e. Perfitojne pension, sipas dispozitave per pensionet familjare, familjaret e te pushkatuarve dhe te te denuarve pa gjyq, te te vdekurve ne burg ose te atyre qe kane vdekur ne burg pa u denuar me gjyq.

Per zbatimin e detyrave te parashikuara nga shkronjat "c" dhe "ç" te ketij neni, ngarkohen komitetet ekzekutive te rretheve dhe te rajoneve.

Keshilli i Ministrave merr parasysh kerkesat e ish te burgosurve dhe te internuarve politike, kur nuk plotesohen kushtet e pikes "c" te ketij neni.

Neni 6

Te drejtat e njohura me nenin 5 te ketij ligji i perfitojne edhe personat e debuar apo te internuar per motive politike.

Neni 7

Te gjitha te drejtat e njohura ne kete ligj per te denuarit politike u njihen dhe familjeve te personave qe kane vdekur gjate procesit te hetimit ose qe jane ekzekutuar pa gjyq.

Neni 8

Per zbatimin e ketij ligji ngarkohen Keshilli i Ministrave, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Drejtesise, Prokuroria e Pergjithshme, Ministria e Financave dhe komitetet ekzekutive te rretheve e te rajoneve.

Neni 9

Te krijohet nje komision me pjesemarrjen e deputeteve, te anetareve te Qeverise, te punonjesve te organeve gjyqesore dhe te anetareve te Shoqates te ish te burgosurve politike per te shqyrtuar dhe evidentuar krimet politike shteterore. Ky komision ngarkohet te kontrolloje dhe zbatimin e ketij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

Tirane, me 30.9.1991
Nr. i ligjit: 7514

Shpallur me dekretin nr. 43, date 1.10.1991 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Ramiz Alia

LIGJ

Nr. 7660, DATE 14.1.1993

PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7514, DATE 30.9.1991 “PER PAFAJESINE, AMNISTINE E ISH TE DENUARVE E TE PERNDJEKURVE POLITIKE”

Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491 “Per dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim te nje grupi deputetesh,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE VENDOSI:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Jane te pafajshem dhe quhen te padenuar per efekte morale, politike dhe ekonomike te gjithë personat e denuar per krime politike, si dhe shqiptaret e dorezuar gjykatave jugosllave per te njejtat motive.

Perfitojne nga ky ligj dhe te vdekurit ne hetuesi, te pushkatuarit pa gjyqe, te vraret ne perpjekje me forcat e diktatures dhe ne kufi per arsye politike, si dhe ata qe jane denuar per shpifje dhe fyerje kunder organeve me te larta te shtetit dhe partise, per shkelje te dekretit nr.7459, date 22.1.1991 “Per respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve qe lidhen me historine kombetare dhe te simboleve shteterore” dhe per shkelje te dekretit nr.7408, date 31.7.1990 “Per mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve ne vendet publike” deri me 22 mars 1992.

Nuk perfitojne nga ky ligj:

Te denuarit per krime kunder shtetit, qe kane qene ne funksione te rendesishme shteterore dhe partiake, sipas percaktimeve qe do te beje Keshilli i Ministrave.

Keta persona kane te drejte te kerkojne rigjykimin e ceshtjes per te provuar veprimtarine e tyre kunder diktatures komuniste.

Çdo force politiko-shoqerore, organ shteteror, grup njerezish ose individ mund te kerkoje rigjykimin e ceshtjes per terror dhe veprimtari antishqiptare per te perjashtuar nje te denuar politik nga perfitimi prej ketij ligji.

Neni 2

Neni 2 te ndryshohet si vijon:

Jane te pafajshem te gjithë shtetasit shqiptare qe jane arratisur nga Shqiperia gjate luftes ose pas çlirimit te vendit deri me 8 maj 1990 per shkak te bindjeve ose veprimtarise se tyre politike.

Neni 3

Ne nenin 5 behen keto shtesa:

1. Ne piken “a” shtohet nje paragraf pas paragrafit te dyte me kete permbajtje:
Per efekt te pensionit, koha e vuajtjes se denimit me heqje lirie te njihet si dyfishi i saj.
2. Para pikes “d” shtohet nje pike me kete permbajtje:
Ish te burgosurve politike, per kohen e qendrimit ne burg ose ne kampet e punes, t’u jepet demshperblimi sipas rregullave qe do te vendosen ne dispozita te vecanta dhe ne perputhje me kriteret nderkombetare, si dhe diferenca e pensionit qe nga koha e lindjes te se drejtes per perfitimin e tij.
Te drejten e pensionit e perfitojne femijet e ish-te burgosurve politike qe vazhdojne studimet pavaresisht nga mosha.
3. Para pikes “dh” shtohet nje pike me kete permbajtje:
Demshperblimi per kohen e qendrimit ne burg ose ne kampet e punes si dhe diferenca e pensionit u jepet dhe familjeve te ish-te burgosurve politike qe nuk jetojne me.
U njihet e drejta e kthimit te pasurive te konfiskuara ose e kompensimit te ketyre pasurive deri ne masen qe perfitojne te gjitha te shpronesuarit e tjere me ligje e vendime te vecanta.

Neni 4

Ne nenin 7 pas fjaleve “qe jane ekzekutuar pa gjyq” shtohen dhe keto fjale:
“te vraret ne perpjekje me forcat e diktatures dhe ne kufi”

Neni 5

Shtohet neni 7 (a) me kete permbajtje:

Vrasja ne perpjekje me forcat e diktatures dhe ne kufi dhe motivet e saj provohen me vendim te gjykates duke u marre dhe mendimi i Shoqates se “Ish-te Denuarve dhe te Perndjekurve Politike”

Neni 6

Te gjitha dispozitat ligjore qe vijne ne kundërshtim me ligjin nr.7514, date 30.09.1991 “Per pafajesine, amnistine dhe rehabilitimin e ish-te denuarve dhe te perndjekurve politike dhe me kete ligj shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

Shpallur me dekretin nr. 426, date 16.1.1993 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Sali Berisha.

LIGJ
NR. 7719, DATE 8.6.1993

**PER DISA SHTESA NE LIGJIN NR.7660, DATE 14.1.1993 “PER DISA
NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7514, DATE 30.9.1991 “PER PAFAJISINE,
AMNISTINE DHE REHABILITIMIN E ISH TE DENUARVE E TE
PERNDJEKURVE POLITIKE”**

Ne mbeshtetje te nenit 16 dhe 23 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 “Per dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e nje grupi deputetesh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Pas paragrafit te pare te nenit 1 te ligjit nr.7660, date 14.1.1993 shtohen dy paragrafe me kete permbajtje:

“Konsiderohet krim politik ajo veper penale qe eshte ndershkuar nga gjykatat ushtarake ne baze te ligjit nr.21, date 15.12.1944 “Mbi sabotatoret e Luftes Nacionalçlirimtare”, te ligjit nr. 41, date 14.1.1945 “Mbi organizimin e funksionimin e gjykatave ushtarake”, te ligjit nr.372, date 12.12.1946. “Mbi fajet penale kunder popullit e shtetit”, te neneve 5 e 6 te ligjit nr.373, date 12.12.1946 “Mbi ndjekjen e tregtise se ndaluar, te spekulimit dhe te sabotimit ekonomik”, si dhe te denuarit sipas te gjithë neneve te kapitullit “Krime kunder shtetit” dhe per moskallezim e perkrahje te ketyre krimeve, sipas Kodit Penal te viteve 1952 e 1977.

Kur ne dokumentet e ish te denuarit politik nuk jane percaktuar qarte keto dispozita ose kur mund te jete denuar me te njejtin vendim edhe per nje krim tjetër ordiner, e kjo mase denimi nuk figuron e ndare, saktesimin e vendos komisioni i krijuar nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Drejtesise. Ky komision verteton dhe faktin e dorezimit te shqiptareve ne gjykatat jugosllave, kur mungojne dokumentet.

Ne paragrafin e dyte te po ketij neni, ne rrjeshtin e trete, pas fjaleve “...arsye politike...” te shtohen fjalet “...ata qe jane akuzuar per krime politike dhe jane mbyllur ne institucione psikiatrike per mjekim te detyrueshem...”

Pas fjaleve “Nuk perfitojne nga ky ligj”, shtohet nje paragraph me kete permbajtje:

“Ata qe vertetohet nga Gjykata e Kasacionit se kane qene krere te larte te organeve te dhunes, terrorit dhe spiunazhit dhe kane bashkepunuar me pushtuesit”.

Pas paragrafit te trete shtohet nje paragraf me kete permbajtje:

“Ata qe kane bere pjese ne nomenklaturen e larte te shtetit komunist dhe ne organet e tij te diktatures, te cilet jane te implikuar ne menyre te drejtperdrejte me fajet te tilla penale si urdhrat per arrestime, burgime, internime e shperngulje te familjeve si pasoje e luftes se klasave dhe qe kane marre pjese aktive ne perdorimin e mjeteve te dhunes kunder te denuarve ne hetuesi, burgje, kampe etj., kur keto vepra provohen me rruge gjyqesore”.

Paragrafi i katert hiqet dhe ne vend te tij vihet nje paragraf i ri me kete permbajtje:

“Personat qe permenden ne dy paragrafet e fundit kane te drejte te kerkojne rigjykimin e ceshtjes per te provuar veprimtarine e tyre kunder diktatures komuniste”. Pas ketij paragrafi shtohet dhe nje paragraf me kete permbajtje: “Ata qe jane denuar per krime ordinere si vrasje, tortura, grabitje, krime seksuale etj”.

Neni 2

Paragrafi i fundit i pikes 3 te nenit 3 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Shtohet neni 7(a) me kete permbajtje:

“Vrasja ne perpjekje me forcat komuniste pas dates 1.8.1943, dhe ne kufi pas dates 31.12.1945 dhe motivet e saj provohen me vendim te gjykates duke u marre dhe mendimi i Shoqates se ish te Denuarve dhe te Perndjekurve Politike”.

Neni 4

Efektet e zbatimit te ketij ligji shtrihen qe nga hyrja ne fuqi te ligjit nr.7660, date 14.1.1993

Shpallur me dekretin nr.585, date 29.6.1993 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Sali Berisha

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
PRESIDENTI**

**DEKRET
PER SHPALLJE LIGJI**

Ne mbeshtetje te nenit 28, pika 4, te ligjit nr.7491, date 29.04.1991 “Per dispozitat kryesore kushtetuese”

Dekretoj

Shpalljen e ligjit Nr.7748, date 29.07.1993 “Per statusin e ish-te denuarve dhe te perndjekurve politike nga sistemi komunist”.

**Tirane, me 04.08.1993
Nr. i Dekretit: 627**

**PRESIDENTI I REPUBLIKES
SALI BERISHA**

**REPUBLIKA SHQIPERISE
KUVENDI POPULLOR**

LIGJ

**PER STATUSIN E ISH-TE DENUARVE DHE TE PERNDJESURVE
POLITIKE NGA SISTEMI KOMUNIST**

Ne mbeshtetje te nenit 16-te te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim te Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

PERKUFIZIME

Neni 1

Statusi i ish-te denuarve dhe te perndjekurve politike qe me poshte quhet "status" permban kriteret dhe kushtet themelore qe nje person te quhet i denuar apo i perndjekur politik, si dhe percakton te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej tij ne perputhje me shkallen e persekutimit.

Neni 2

Perndjekja politike, qe me poshte do te quhet "perndjekje", quhet çdo veprim ose mosveprim i kryer qe nga data 8.11.1941 deri me daten 22.3.1992 nga ana e çdo formacioni ose individi te armatosur, e Ushtrise Nacionalclirimtare, e sigurimit te shtetit, e policise, e ushtrise apo nga ana e organeve te pushtetit lokal me urdher ose vendim te organeve partiake, luftarake, shtetore apo te gjykatave te komunisteve shqiptare, kur ky veprim ose mosveprim ka shkaktuar humbjen e jetes., te lirise, te te drejtave qytetare, cilesimin kulak, i deklaruar, si dhe çdo privim tjeter nga pjesemarrja ne jeten politike, ekonomike dhe shoqerore te individit per hir te bindjeve apo qendrimit te tij politik a fetar.

**KATEGORIZIMET E ISH-TE DENUARVE E TE PERSEKUTUARVE
POLITIKE**

Neni 3

Ne baze te ligjit: Per pafajesine dhe amnistine e ish-te denuarve dhe te perndjekurve politike" nr.7516, ndryshuar me ligjin nr.7660, date 14.1.1993 dhe me ligjin nr.7719, date 8.6.1993, te perndjekurit politike sipas ketis statusi ndahen ne pese kategori:

- a. Persona qe kane humbur jeten ose jane te semure psiqike per shkak te perndjekjes.

- b. Persona qe jane denuar me heqje lirie ose kane qendruar ne arrati brenda vendit per shkak te perndjekjes.
- c. Persona qe jane denuar me internim, debim per shkak te perndjekjes; persona shqiptare qe kane patur shtetesi te huaj, sot shtetesi shqiptare, e qe kane jetuar ne kampe perqendrimi te ngritura posaçerisht per ta.
- d. Persona qe kane humbur te drejtat qytetare, kulaket e fshatit, te deklasuarit dhe ata qe kane pesuar privilegje te llojeve te ndryshme per shkak te perndjekjes.
- e. Persona, te cilet megjithese plotesojne kushtet per t'u kategorizuar ne nje nga kategorite e mesiperme, nuk perfitojne te drejten e ketij statusi.

Neni 4

Personat shtetas shqiptare te cilet jeten, lirine ose privilegje te tjera qe permenden ne nenin 3 pikat a, b, c dhe d, i kane humbur jashte territorit te Shqiperise gjate kohes qe kane punuar ne administraten e atjeshme ne vitet e luftes antifashiste ose me pas si rezultat i pamundesise per te qendruar ne Shqiperi nga perndjekja qe u eshte bere, pavaresisht se veprimi perfundimtar i perndjekjes eshte kryer nga forcat komuniste joshqiptare, perfitojne te drejtat e plota qe garantohen ky status.

Neni 5

Personat e kategorizuar ne nenin 3 pika "e" jane:

- a. Nomenklatura e larte komuniste sipas kriterëve te miratuara nga ana e Keshillit te Ministrave.
- b. Bashkepunetoret e sigurimit te shtetit, deshmitare te gjyqeve politike, aktiviteti i te cileve ka cuar direkt ne krime si vrasje, burgime, internime, debime etj te qytetareve.
- c. Te denuarit politike, qe ne perberjen e vendimit te gjykates, pjesen e krimit te vjedhjes, grabitjes, vrasjes, plagosjes se rende e kane te barabarte ose me te madh se denimi politik si dhe perdhunuesit.
- d. Te denuarit ose te internuarit politike, te cilet ne perberjen e denimit te tyre politik kane edhe nene ordinere te permendura ne piken "c" te ketij neni dhe perpara ketij denimi jane denuar dhe dy here te tjera per motivet e vjedhjes e te grabitjes, pavaresisht nga masa e denimit.
- e. Personat e kategorizuar sipas nenit 3 pika "d", kur iu ka humbur e drejta morale per t'u quajtur te tille per shkak te pohimit publik te bindjeve te tyre politike ose te mohimit te lidhjeve me personat e tyre te afert te kategorizuar sipas nenit 3 pikat a, b, c dhe d, kur kjo gje vertetohet me shkrim nga vete personi i perndjekur sipas pikave te mesiperme, shkak i perndjekjes.
Ne rast se personi ka vdekur, kete e vendos gjykata me propozim te kryesive dhe te Shoqates te te Denuarve dhe te Persekutuarve Politike te lagjes ose fshatit ku banon ose ka banuar.
- f. Ata qe vertetohet nga Gjykata e Kasacionit se kane gene krere te larte te organeve te dhunes, terrorit dhe spiunazhit dhe kane bashkepunuar me pushtuesit.

Neni 6

Te gjithë pjesetaret e familjes apo te afermit e atyre personave qe analizohen ne nenin 5 te ketij ligji do te perfshihen ne pike “d”te nenit 3 kur i plotesojne kushtet per nje gje te tille, pavaresisht se personi shkaktar i perndjekjes te tyre nuk e perfiton te drejten e statusit.

TE DREJTAT

E drejta e kompensimit ne vlere

Neni 7

Kompensimi pasuror i te perndjekurve politike do te quhet: shperblimi i menjehershëm ne te holla, pensioni jetesor, kompensim rroge, toke, lokal dhe forma te tjera perfitimi material, te cilat do t'i jepen personit te perndjekur ose familjes se tij kur ai ka vdekur, pa kthim, ne kompensim te jetes, humbjes se lirise, punes se papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qellim kryesor krijimin e kushteve dhe te mundesive per nje integrim sa me te shpejte te tij dhe te familjes se tij ne jeten normale ekonomike-shoqerore te vendit tone. Forma e kompensimit pasuror percaktohet me vendim te vecante te Keshillit te Ministrave.

Neni 8

Kompensimi pasuror i percaktuar sipas nenit 7 perfshin kategorite e permendura ne nenin 3 pikat a, b dhe c. Nga kjo e drejte nuk perfitojne te perndjekurit e pikes “c” te cilet gjate kohes qe kane gezuar liri te kufizuar jane paguar per punen e kryer.

Per personat e kategorizuar ne piken “a”, pervec te drejtes se pensionit te njohur nga dispozitat e meparshme ligjore, jepet dhe shperblim i menjehershëm ne te holla. Masa e shperblimit caktohet ne dispozite te vecante mbas miratimit te ketij ligji.

Neni 9

Koha per te cilen do te llogaritet kompensimi do te jete kohezgjatja e plote ne dite e denimit sipas pikes “b” dhe “e” te nenit 3.

Llogaritjet ne vlere te kompensimit per kete kohezgjatje do te behen duke u bazuar mbi pagen baze me te larte te sistemit te minierave qe rezulton nga viti 1945 deri me 31.12.1990, korrigjuar me indeksin mesatar te rritjes se çmimeve ne momentin e llogaritjes se kompensimit.

Neni 10

Proçesi i regjistrimeve per njohjen e te drejtes se statusit do te vazhdoje deri me 31.12.1993. Mbas ketij afati nuk do te pranohen me kerkesa, pervec rasteve te pamundesise se plote te vertetuar me vendim gjykate.

Neni 11

Tre muaj pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji te filloje kompensimi pasuror.
Ky kompensim do te perfundoje me daten 31.12.1994

Te drejta te tjera

Neni 12

Te gjithë atyre personave qe perfshihen ne nenin 3 pikat a, b, c dhe d, Qeveria me ane te akteve te veçanta te saj do t'iu garantoje krijimin e lehtesirave dhe te perpresive te kerkesave te tyre individuale, apo kolektive ne fushat e meposhtme te veprimtarise ekonomike, financiare dhe sociale:

- a. Ne fushen e privatizimit te prones shteterore
- b. Ne fushen e dhenies se kredive
- c. Ne fushen e ndertimeve dhe strahimit
- d. Ne fushen e turizmit
- e. Ne fushen e arsimit dhe te kualifikimit
- f. Ne fushen e punesimit brenda dhe jashte vendit.
- g. Ne fushen e realizimit te programeve te ndryshme ekonomike dhe sociale kombetare dhe nderkombetare
- h. Ne fushen e sherbimit shendetesor

Afati i perfundimit te ketyre perpresive vendoset me ligj te veçante.

DISPOZITA TE NDERMJETME

Neni 13

Te gjithë atyre personave, te cilet kategorizohen ne nenin 5, pikat "b", "c" dhe "d", pavaresisht se nuk ju njihet e drejta e ketij statusi, ju jepet kompensim pasuror ne perputhje me percaktimet e ketij ligji.

Neni 14

E drejta e statusit eshte personale. Te drejttat pasurore qe rrjedhin nga ky status mund te transmetohen tek trashegimtarët pas dispozitave te Kodit Civil mbi trashegimine, por vetem nje here dhe vetem per personat qe perfshihen ne pikat a, b dhe c te nenit 3.

ORGANET DHE PROCEDURA PER DHENIEN E STATUSIT

Neni 15

Per dhenien e te drejtes se statusit ngrihet nje komision tri palesh i perbere nga:

- a. tre perfaqesues te Ministrise se Drejtesise,
- b. tre perfaqesues nga Komiteti Shteteror i te Perndjekurve Politike
- c. tre perfaqesues nga Shoqata Kombetare e te Perndjekurve Politike

Niveli i perfaqesimit dhe procedura e mbledhjes percaktohen me dispozite te veçante nga Keshilli i Ministrave.

Neni 16

Dokumentet e vlefshme per dhenien e te drejtes se statusit sipas rasteve te percaktuara ne pikat a, b, c, dhe d, te nenit 3, jane keto:

Per piken a:

-Vertetim i Komisionit te Ministrise se Rendit ose Ministrise se Drejtesise kur personi eshte vrare ose ka vdekur per shkak te perndjekjes.

-Raport mjeko-ligjor i kohes kur personi i perndjekur ka humbur gjykiin per shkak te perndjekjes, si dhe raport mjeko-ligjor i sotem ku te vertetohet se kjo gjendje vazhdon dhe sot, ose deri ne daten e vdekjes, ne rastet kur i perndjekuri nuk jeton me. Shkalla e semundjes qe perfiton te drejtat e pikes "a" percaktohen nga nje komision i ngritur posaçerisht per kete qellim nga Ministra e Shendetesise.

Per piken b:

-Deshmi penaliteti nga Ministria e Drejtesise per kohen e ndejtjes ne burg.

-Vendim te gjykatave te sotme qe vertetojne kohezgjatjen e ndejtjes ne arrati ne rastin e te arratisurve brenda vendit.

Per piken c:

-Vendime te gjykatave ose komisioneve te internimeve ose te Ministrise se Rendit Publik.

Per piken d:

-Deshmite e personave te denuar ose te internuar, shkaktare te perndjekjes te personave te tjere, por jo me larg se nipi ose mbesa, ne te dy kuptimet, si dhe çdo deshmi tjeter dokumentare, vendim gjykate ose jo, qe do te vertetoje perndjekjen e kujtdo per shkak te lidhjeve te tij farefisnore ose shoqerore me persona te perndjekur qe perfshihen ne nenin 3 pikat a, b dhe c, duke perfshire dhe rastet qe pershkruhen ne nenin 6 te ketij ligji.

Ne te gjitha rastet, kur nuk eshte e mundur te sigurohen deshmite e dokumentuara te kohes kur eshte kryer perndjekja, te gjitha personave te interesuar iu lind e drejta qe çeshtjen ta zgjidhin me gjyq.

Neni 17

Te gjitha dokumentat e parashikuara nga neni 16 do te mblidhen nga kryesite e shoqatave te ish-te denuarve dhe te persekutuarve politike dhe te shoqatave te ish-persekutuarve politike dhe ekonomike te lagjeve, fshatrave dhe qyteteve ne bashkepunim me inspektoret shteterore te perndjekurve politike te rretheve, te cilet do t'ia percjellin Komitetit te ish-te Perndjekurve Politike, i cili i pergatit dhe i paraqet per shqyrtim ne mbledhjen e komisionit tripalesh.

Neni 18

Komisionit tripalesh, qe permendet ne nenin 15, i jepet e drejta qe ne baze te propozimeve te Kryesise Kombetare te Shoqates se ish-te Denuarve dhe te Perndjekurve Politike, te shqyrtoje raste te veçanta per dhenien e se drejtes te statusit per te gjitha ata persona qe perjashtohen nga kjo e drejte e kategorizuar ne nenin 5 te

ketij ligji. Mbas shqyrtimit te ketyre kerkesave, vendimi i ketij komisioni eshte i paapelueshem.

Neni 19

Personat qe perfitojne statusin padrejtesisht detyrohen te kthejne shumen e marre ne formen e kompensimit pasuror qe rrjedh nga te drejtat e ketij statusi.

Personat qe te drejten e ketij statusi e kane fituar me dokumente te falsifikuara, kur kjo gje vertetohet ligjerisht, pervec kthimit te shumes se perfituar padrejtesisht, ndiqen penalisht sipas dispozitave ne fuqi.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 20

Te gjitha dispozitat ligjore qe bien ne kundertshtim me kete ligj shfuqizohen, pervec rasteve kur eshte parashikuar ndryshe nga vete ky ligj.

Neni 21

Organi shteteror kompetent per zbatimin e te drejtave qe rrjedhin nga ky status eshte Komiteti Shteteror i te Perndjekurve Politike.

Neni 22

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

Tirane, me 29.7.1993

Nr.i ligjit: 7748

KRYETARI I KRYESISE
Pjeter Arbnori

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

LIGJ

Nr.9260, date 15.7.2004

**PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7748, DATE 29.7.1993
“PER STATUSIN E ISH TE DENUARVE DHE TE PERNDJEKURVE
POLITIKE NGA SISTEMI KOMUNIST”, I NDRYSHUAR**

Ne ligjin nr. 7748, date 29.7.1993 “Per statusin e ish te denuarve dhe te perndjekurve politike nga sistemi komunist”, i ndryshuar, behen keto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 9 ndryshohet si me poshte:

“Kompensimi financiar i ish te denuarve dhe te perndjekurve politike, qe kane marre pafajesine sipas ligjit nr.7514, date 30.9.1991 “Per pafajesine, amnistine e ish te denuarve dhe te perndjekurve politike”, i ndryshuar dhe qe gezojne statusin sipas ligjit nr.7748, date 29.7.1993 “Per statusin e ish te denuarve dhe te perndjekurve politike nga sistemi komunist”, i ndryshuar, ish te denuarit politike qe perfshihen ne kategorine “A”, te cilet kane humbur jeten apo jane te semure psikike per shkak te perndjekjes ose trashegimtarit te radhes se pare sipas Kodit Civil, si dhe ish te denuarit politike qe perfshihen ne kategorine “B” te parashikuar ne nenin 3 te ligjit nr 7748, date 29.7.1993 “Per statusin e ish te denuarve dhe te perndjekurve politike nga sistemi komunist”, i ndryshuar, perfitojne te drejten e kompensimit financiar ne menyre te pershkallezuar mbi bazen e vuajtjes se denimit si me poshte:

Periudha e vuajtjes se denimit	Pagesa mujore ne leke
1 deri ne 5 vjet	1 500
5 deri ne 10 vjet	2 000
10 deri ne 15 vjet	2 500
15 deri ne 20 vjet	3 000
20 deri ne 30 vjet	3 500
Te pushkatuar	5 000

Neni 2

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me kete permbajtje:

“Neni 21/1

Per zbatimin e ktij ligji ngrihet nje komision i perbere nga perfaqesues te Ministrise se Drejtesise, Ministrise se Financave, Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe Komitetit te Integritimit te te Perndjekurve Politike.

Organizimi dhe funksionimi i ketij komisioni percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.”

Neni 3

Pas nenit 21/1 shtohet neni 21/2 me kete permbajtje:

“Neni 21/2

Kunder vendimeve te Komisionit, te parashikuar ne nenin 2 te ketij ligji, mund te behet ankim ne perputtje me ligjin nr. 8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative””.

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji, ngarkohet Keshilli i Ministrave te nxjerre aktet nenligjore ne zbatim te neneve 1 dhe 2 te tij.

Neni 5

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Servet Pellumbi